

**STATUT I SHOQERISE
"SERENITE" Sh.p.k**

Ky Statut do te konsiderohet se inkorporon dhe/ose perfshin Aktin e Themelimit te Shoqerise organizimi dhe funksionimi i te ciles rregullohet ketu.

Sot, me 07 Qershor 2024:

ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", te ndryshuar, dhe me legjislacionin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, miraton kete Statut si vijon:

**KAPITULLI I
THEMELIMI – EMRI – FORMA – SELIA - OBJEKTI – KOHEZGJATJA**

**Neni 1
Themeli, Emri dhe Forma**

Emri dhe emertimi tregtar i Shoqerise eshte "**Serenite**" Sh.p.k.

Shoqeria "**Serenite**" Sh.p.k eshte nje person juridik privat, e themeluar ne baze te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" (me pas referuar si "Ligji Tregtar") ne formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar (Sh.p.k).

Shoqeria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar qe mbahet nga Qendra Kombetare e Biznesit (ne vijim referuar si "QKB") ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga ligji.

Me fitimin e personalitetit juridik, Shoqeria behet pergjegjese kundrejt paleve te treta, per detyrimet dhe demet qe shkakton gjate veprimtarise se saj.

Ortaket e Shoqerise do te jene pergjegjes kundrejt paleve te treta deri ne shumen e kontributit te derdhur ne kapitalin themeltar te Shoqerise.

**Neni 2
Selia**

Shoqeria do ta kete seline e saj ne adresen e me poshtme: Rr "Reshit Çollaku" Tirane, Nr Ap 101, me nr pasurie 7/135+8-101, zk 8380, vl 28, fq 131.

**Neni 3
Objekti**

Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jetë:

Dhenie e apartamentit me qera.

Objekti i aktivitetit te Shoqerise mund te ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe kete Statut.

**Neni 4
Kohezgjatja**

Kohezgjatja e Shoqerise do te jete e pakufizuar. Shoqeria mund te prishet ne cdo kohe me nje vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

KAPITULLI II KAPITALI – KUOTAT

Neni 5 Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 10,000 (Dhjete mijë) Leke.

Kapitali themeltar zoterohet nga 2 ortake themelues si vijon:

- **Z. Leonalb Lena**, mbajtes i leternjoftimit ID nr. 034996588, numer personal K20711037E, zoterues i 1 (nje) kuote me vlera 5,000 (pese mijë) Leke qe perben **50% te kapitalit themeltar te shoqerise**;
- **Z. Flamur Gaxhenji**, mbajtes i leternjoftimit ID nr. 039362038, numer personal I90616069W, zoterues i 1 (nje) kuote me vlera 5,000 (pese mijë) Leke qe perben **50% te kapitalit themeltar te shoqerise**

Ortaket jane pergjegjes kundrejt paleve te treta per humbjet qe peson Shoqeria, deri ne shumen e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar mund te zmadhohet ose te zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore.

Neni 6 Kuotat Te drejtat dhe detyrimet e lidhura

Secili ortak do te kete nje numer proporcional votash me vleren nominale te kuotes se tij.

Titulli i pronesise mbi kuotat do te regjistrohet ne regjistrin e ortakeve i cili do te mbahet ne seline e Shoqerise nen pergjegjesine e Administratoreve (ne vijim “**Regjistri i Ortakeve**”).

Regjistri i Ortakeve do te pasqyroje informacionin e meposhtem: (i) identitetin e cdo Ortaku; (ii) numrin dhe vleren e kuotes qe zoterohet nga cdo Ortak; (iii) daten e fitimit te pronesise se secilit Ortak mbi kuotat; (iv) adresen apo seline e cdo Ortaku; (v) detaje per cdo peng apo barre te vendosur mbi kuotat.

Neni 7 Kalimi i Kuotave

Ne rastet e kalimit te kuotave me kontrate, kushtet dhe momenti i kalimit te titullit te pronesise mbi kuoten, si dhe kushtet e tjera te kalimit, perfshire momentin e pageses se çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata per kalimin e kuotes hartoheret ne forme shkresore dhe noterizimi nuk perben kusht per vlefshmerine apo regjistrimin e kontrates.

Neni 8 Zmadhimi i Kapitalit

Kapitali themeltar mund te zmadhohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, nepermjet emetimit te kuotave te reja ose rritjes se vleres nominale te atyre ekzistuese ose ne cdo forme tjeter te parashikuar nga Ligji.

Per cdo zmadhim kapitali te Shoqerise nepermjet emetimit te kuotave te reja, Ortaket do te kene te drejten e parablerjes per nenshkrimin e ketyre kuotave te reja te emetuara. Nese me shume se 1 (nje) Ortak ushtrojne te drejtat e tyre te parablerjes brenda 20 (njezet) diteve, atehere ata do t'i blejne

keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar. Çdo kuote e re qe nuk eshte blere nga Ortaket gjate ketij procesi, i ofrohet çdo pale te trete.
Kuotat e reja qe do te shlyhen si me para ne dore, ashtu edhe ne natyre, do te paguhen ne perputhje me Vendimin perkates per zmadhimin e kapitalit dhe Ligjin per Shoqerite Tregtare.

Neni 9 **Zvogelimi i Kapitalit**

Kapitali mund te zvogelohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare.

KAPITULLI III **ORGANET E SHOQERISE**

Neni 10 **Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve**

Asambleja e Pergjithshme do te jete organi me i larte i Shoqerise, i cili, veç kompetencave te tjera sipas Ligjit per Shoqerite Tregtare apo ketij Statutit, merr vendime per çeshtjet e meposhtme te Shoqerise:

- a. percaktimi i politikave tregtare;
- b. ndryshime te Statutit;
- c. emerimi i Administratoreve;
- d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel te autorizuar;
- e. miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
- f. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve te ecurise se veprimitarise se Shoqerise;
- g. shperndarjen e fitimeve vjetore;
- i. zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar te Shoqerise;
- j. pjesetimin dhe anulimin e kuotave;
- k. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime;
- l. riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
- m. miratimin e rregullave te zbatueshme procedurale te mbledhjeve te saj;
- n. çeshtje te tjera sipas parashikimeve te bera prej ketij Statuti.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme mund te dergohet me shkrim apo e-mail ne adresat qe secili Ortak do t'i njoftoje me shkrim Shoqerise me poste te regjistruar. Njoftimi do te konsiderohet se i eshte dorezuar Shoqerise me kalimin e dites se 10-te pas dergimit.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te percaktoje qarte emrin e Shoqerise, seline, daten, kohen dhe vendin e mbledhjes, nje pershkrim te hollesishem te procedures qe duhet te ndiqet nga Ortaket per pjesemarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e menyren e marrjes se dokumenteve dhe projekt-vendimeve qe duhet tu vihen ne dispozicion te gjithe Ortakeve, po ashtu edhe rendin e dites, dhe duhet t'u njoftohet Ortakeve te pakten 14 (katermbedhjete) dite para mbledhjes. Rendi i dites i njoftuar si me siper duhet te permbojte edhe vendimet e propozuara per çdo çeshtje. Nese Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose per ndryshime te Statutit, teksti perkates duhet te njoftohet se bashku me rendin e dites.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te thirret nga Administratoret dhe, kur eshte e zbatueshme, nga Ortaket.

Nje Ortak mund te perfagesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete i ndryshem nga Administratoret, duke paraqitur dokumentin perkates autorizues. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelinin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per çeshtje te tjera si: percaktimi i politikave tregtare te shoqerise; emerimin e administratoreve; emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar; percaktimin e shperblimeve; mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga Administratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise; perfason e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve; miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga Ligi Tregtar, vlefshmeria e vendimeve qe percaktojne detyrime shtese ose kufizojne / zvogeljne te drejtat qe u jane njojur ortakeve nga Ligi Tregtar apo nga ky Statut, kushte zohet nga miratimi i Ortakut te interesuar / perkates.

Te gjitha vendimet e Asamblese duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratoret jane perjegjes per mbajtjen e nje kopjeje te tij.

Neni 11 **Organi Administrues / Administratoret**

Organi Administrues perbehet nga 2 (dy) Administratore qe emerohen e shkarkohen nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve. Kohezgjatja e mandatit te Administratorit eshte 5 (pese) vjet, me te drejte ri-emerimi.

Caktohen si Administratore te pare te shoqerise me mandat 5 vjeçar:

- **Z. Leonalb Lena**, mbajtes i leternjoftimit ID nr. 034996588, numer personal K20711037E, shtetas shqiptar, lindur me 11.07.2002.
- **Z. Flamur Gaxhenji**, mbajtes i leternjoftimit ID nr. 039362038, numer personal I90616069W, shtetas shqiptar, lindur me 16.06.1989.

Administratori perfason Shoqerine sipas parashikimeve te Statutit.

Administratori do te:

- (i) administroje veprimtarine tregtare te Shoqerise duke zbatuar politikat tregtare te miratuara nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve;
- (ii) perfason e Shoqerine;
- (iii) kujdeset per mbajtjen e rregullit te librave dhe dokumenteve kontabel;
- (iv) perqatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe reportin e ecurise se veprimtarise, te cilat la paraqet Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve per miratim, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve;

- (v) krijoje nje sistem njoftimi te pershtatshem per rrrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
- (vi) kryeje regjistimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjit Tregtar apo te ligjeve te tjera te zbatueshme;
- (vii) raportoje perpara Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve mbi zbatimin e politikave tregtare si dhe per perfundimin e transaksioneve me rendesi te veçante per performancen e Shoqerise;
- (viii) kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin Tregtar dhe ne kete Statut;
- (ix) therrase mbledhjen e Asamblese se Ortakeve sa here qe kerkohet sipas Ligjit apo ketij Statuti. Administratori mund te autorizoje persona te tjere per te vepruar ne emer dhe per llogarine e tij, duke specifikuar / percaktuar kategorine e akteve dhe vepprimeve qe perfaquesuesi mund te kryeje. Veç kufizimeve ligjore, nuk vendosen kufizime te kompetencave te administritmit.

Neni 12
Kontrolli i Shoqerise

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te emeroje nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar per kontrollin e llogarive te Shoqerise.

KAPITULLI IV
VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, FITIMET DHE REZERVAT LIGJORE

Neni 13
Viti Financiar

Viti financiar ka nje kohezgjatje prej 12 (dymbedhjete) muajsh e cila fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

Ne menyre perjashtimore, viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

Neni 14
Rezerva Ligjore

Shoqeria do te kaloje ne fondin rezerve te detyrueshem te pakten 5% (pese perqind) te fitimit vjetor neto derisa kjo rezerve te arrije vleren e barabarte me 10 per qind te kapitalit themeltar.

Neni 15
Dividendet

Pas miratimi te bilancit vjetor dhe percaktimit te shumes qe do te ndahet, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve percakton shumen e fitimeve qe do t'i shperndahet secilit prej Ortakeve si dividend, ne perpjestim me pjesen perkatese ne kapitalin themeltar.

KAPITULLI V
PRISHJA - LIKUIDIMI

Neni 16
Prishja e Shoqerise

Shoqeria prishet (i) me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve; ose (ii) ne rast falimentimi; ose (iii) kur Shoqeria nuk ka kryer veprimtari per 2 (dy) vjet dhe nuk eshte njofteuar pezullimi i veprimtarise ne QKB; ose (iv) me vendim gjykate; ose (v) per arsyte tje te parashikuara ne ligj.

Neni 17

Likuidimi

Me perjashtim te rastit te fillimit te nje procedure falimentimi, prishja e Shoqerise shoqerohet me fillimin e procedures se likuidimit.

Neni 18

Dispozita Perfundimtare

Per te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen parashikimet e Ligjit Tregtar.

Konfliktet ne lidhje me kete Statut do te zgjidhen nga gjykata e rrethit gjyqesor ne territorin e se ciles Shoqeria ka seline e saj.

Me qellim shmangjen e cdo paqartesie, ndryshimi i ortakeve dhe/ose Administratorit, dhe/ose cdo funksionari tjeter nuk do te konsiderohen si ndryshime te ketij Statuti.

Ky Statut nenshkruehet rregullisht ne gjuhen Shqipe.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

Z. Leonalb Lena



Z. Flamur Gaxhenji

